

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" Rracaj " shpk

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Bazuar ne ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 i ndryshuar si dhe akteve nenligjore ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " ,si dhe Ligjit Nr 9723 date 03.05.2007Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",i ndryshuar,si dhe te gjitha akteve ligjore dhe nenligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi

U vendos si me poshte:

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 21 Gusht 2025 , Une themeluesi ortak i vetem ,kam vendosur krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emer **"Rracaj" shpk**

1. Themeluesi eshte ortak i vetem

- a) **Lush Danaj** , atësia Sadik shtetas kosovar, identifikuar me anë të pasaportës ID0882240 ,me numër personal identifikimi 1500490035 i datëlindjes 24.05.1975,lindur në Gjakove, banues Rracaj. Rracaj Gjakove në Kosovë (sipas Çertifikates ekstraktit te gjendjes civile) madhor me zotësi të plotë jurdidike për të vepruar.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) Ne fushen e tregtimit të materialeve të ndërtimit dhe ndertimit te godinave te thjeshta te banimit shtepi private , vila , rezidence , apartamente dhe blloqe apartamentesh , rikonstruksione te godinave ekzistuese te te çdo lloji e tjer
- b) Ne fushen e tregtimit te artikujve te ndryshem ushqimore , industriale ,dhe te te gjithdha llojeve si elektroshtepiake elektrike elektronike dhe produkteve dhe sherbimeve te te gjitha llojeve qe kerkon tregu shqiptare dhe interesi i i shoqerise time ne kushtet kohore te tregut
- c) Ne agroturizem bregdetare dhe malore sipas nevojave te tregut dhe mundesise time ne kohe reale pa kufizim dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi
- d) Ne fushen minerarae te kerkim –zbulimit shfrytezimit , perpunimit te te gjitha mineraleve, hidrokarbureve e te tjere qe tregu shqiptare ka disponon dhe ofron te disponueshme per operatoret e ndryshem ekonomik investore vendas dhe te huaj qe jane te aksesuesheshme ne territorin e Shqiperise
- e) Ne fushen e tregut imobilare te pasurive te luajteshme dhe te paluejteshme per mallra dhe sherbime qe tregu shqiptare ka nevojë dhe treg dhe mundesi njehkosisht per operatoret e ndryshem si dhe Une shprehin interes mbi keto nevoja dhe mundesi reale tregu.


Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

Faqe 1 e 8

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
" Rracaj " shpk



Neni 4:
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Lagjen "Dardania", Rruga "Harry Bajraktari" Pallati nr15 Hyrja nr 12 Apartamenti 6 kodi postae 8701 Qyteti Bajram Curri Bashkia Tropoje Qarku Kukës
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar


- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë ne para ose edhe ne natyre dhe është i ndarë në 1 (Një) kuote. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtem
 - a) Ortaku i vetem themelues **Lush Danaj** zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000(Njëqindmijë) lekë,që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakut/ve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri e paluajtshme/luajtshme apo të drejta.

Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet vendimeve të shoqërisë se ortakut apo ortakëve ne varesi të dinamikës tregtare të shoqërisë përmes vendimit të ortakut/ ortakëve të miratuar nga asambleja apo përmes emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto ne kontribut sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit vendoset nga asambleja e ortakut/ëve (apo personave të autorizuar me prokurë në përputhje me legjislacionin në fuqi), e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.
- 3) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakun/et në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakut/ëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve/ ortakut te vetem është organi i me i larte vendimmarrës i Shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve/ortakut te vetem është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/et, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë (i përfaqësuar me prokurë te posaçme sipas legjilacionit shqiptare ne fuqi) .
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. (vetem ne rastet kur legjislacioni ne fuqi e parashikon dhe e lejon te tille
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. (por kjo nuk e kufizon nje gje te tille kur ligji dhe e derjta ja lejon)


Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Korumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë

Faqe 3 e 8
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
" Rracaj " shpk



vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- 1) Asambleja e përgjithshme e ortakut të vetëm vendos afati i emërimit, është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Administratori i vehtem i Shoqërisë emërohet **Lush Danaj** atësia Sadik , shtetas kosovare mbajtes i ID-se 0882240 dhe me nr personal 1500490035 i datëlindjes **24.05.1975** lindur ne **Rracaj GJAKOVE** dhe banues ne **Rracaj Gjakove KOSOVE**
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit (ose personi i pajisur me prokurë të posaçme) prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve


Faqe 4 e 8
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
" Rracaj " shpk

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Kur nuk parashikohet ndryshe në aktin e emerimit, nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht Shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të

Faqe 5 e 8
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Rracaj" shpk



rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR, AUDITORI

Neni 16 Viti Financiar

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertët


- 1) Eksperti ka të drejtë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike –tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është i ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar prej ortakëve.
- 2) Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i utorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që të ua paraqesë e dorëzojë në kohë të gjithë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;

Faqe 6 e 8
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
" Rracaj " shpk



- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".
 - 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
 - 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
 - 5) Nëse Ortaket/ortaku nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet gjykatës kompetente.

ORTAKU I VETEM

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Rracaj " shpk

1. Ortaku themelues Lush Danaj

Lush Danaj

Danaj